

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-190/13**

**Prishtinë,**

**6 Maj 2015**

Në çështjen juridike të:

**F. F.**

Istog

***Pala ankuese***

kundër

**D. A.**

Serbi

***Pala përgjegjëse në ankesë/Paraqitësi i kërkesës***

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it dhe Rolandus Bruin Gjyqtar i EULEX-it, anëtarë të trupit gjykues, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/133/2011, të datës 7 dhjetor 2011, lidhur me lëndën KPA40955, pas shqyrtimit të mbajtur me 6 Maj 2015, mori këtë

## AKTGJYKIM

**Hedhet si e papranueshme ankesa e F.F. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/133/2011, të datës 7 dhjetor 2011, për sa i përket lëndës KPA40955.**

### Përmbledhja e çështjeve procedural dhe faktike:

1. Më 30 maj 2007, D. A. (në tekstin e mëtejshëm: paraqitësi i kërkesës) në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) për vërtetimin e së drejtës së tij pronësore dhe ri-posedimin në ngastrën nr. 393, me sipërfaqe prej 0ha 4ar 40m<sup>2</sup>, Fleta Poseduese nr. 4, Zona Kadastrale Mojtir, Komuna e Istogut (në tekstin e mëtejshëm: prona e kërkuar).
2. Paraqitësi i kërkesës thekson se pronën e kërkuar e kishte trashëguar nga gjyshi i tij M. A., dhe se e njejta ishte uzurpuar nga persona të panjohur. Ai në mes tjerash ka kërkuar edhe kompenzimin për shfrytëzimin e pronës së kërkuar
3. Për ta mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës paraqiti në AKP këto dokumente:
  - Fletën poseduese nr. 4 të datës 1 shkurt 2002 nxjerrë nga Drejtoria për Kadastër e Komunës së Istogut;
  - Vendimin e trashëgimisë T.nr.195/06 i datës 28 mars 2006, i lëshuar nga Gjykata Komunale e Borit, Republika e Serbisë. Sipas këtij vendimi paraqitësi i kërkesës shpallet trashëgimtar i gjyshit të tij M. A., ne mes të tjerash edhe për pronën e kërkuar (ngastrën kadastrale nr. 393);
  - Çertifikata e lindjes së paraqitësit të kërkesës nr. M-07-200-8/4066 e datës 17 nëntor 2005 lëshuar nga Republika e Serbisë;
  - Çertifikata e vdekjes së M. A. (gjyshit të paraqitësit të kërkesës) nr. 07-203-5-98/2008-III datë 24 September 2008, e lëshuar nga Republika e Serbisë;
  - Leternjoftimi nr. P 118.464 lëshuar me datë 16 October 2000 nga Republika e Serbisë.
4. Ekipi i Njoftimit i AKP-së ka verifikuar pozitivisht të gjitha dokumentet e theksuara, përpos aktvneidmit të trashëgimisë.
5. Me 2 prill 2008, ekipi njoftuese i AKP-së shkoi në vendin ku ndodhej ngastra e kërkuar dhe vendosi një shenjë që tregonte se prona ishte objekt i kërkesës, dhe se palët e interesuara duhej të paraqitnin përgjigjet e tyre brenda 30 ditëve. Prona (tokë komerciale pa objekte, tokë/pyll) është gjetur pa shenja të uzurpimit. Me datën 1 korrik 2010, AKP-ja përmes publikimit në Gazetën Njoftuese të AKP-ës nr. 3 dhe Buletinit të Zyrës së UNHCR ka konfirmuar njoftimin e bërë të kërkesës.
6. Sipas raportit të korrespondecës së datës 19 maj 2009, shihet se paraqitësi i kërkesës ishte pajtuar që kërkesa e paraqitur nga ai para AKP-ës, të procedohej në emrin e gjyshit të tij M. A. (kjo sepse paraqitësi i

kërkesës nuk kishte paraqitur asnjë dëshmi për të dokumentuar vdekjen e gjyshit). Kjo dmth se bartësi i së drejtës pronësore në procedurën e mëtuqeshme para AKP/KKPK-ës është konsideruar M. A. (në tekstin e mëtejme: bartësi i së drejtës pronësore) dhe jo paraqitësi i kërkesës. Ndërsa sipas raportit tjetër të datës 15 tetor 2010 shihet se paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se Ć. A. – babai tij, ishte i vetmi djalë i M. A. dhe se ai nuk kishte tjetër trashëgimtar.

7. Pasi që askush nuk reagoi ndaj njoftimit, kërkesa u trajtua si e pakontestueshme.

8. Më 7 dhjetor 2011, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) mori vendimin grupor KPCC/D/A/133/2011, duke vërtetuar të drejtën pronësore të bartësit të drejtës pronësore mbi pronën e kërkuar, si dhe duke konfirmuar të drejtën e tij për posedimin e pronës në fjalë.

9. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 18 tetor 2012. Në të njejtën datë paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë pranë AKP-ës për vënjen në administrim të pronës së kërkuar.

10. Më 18 korrik 2013, F. F. (më tutje: pala ankuese) paraqiti ankesë kundër vendimit të KKPK-së KPCC/D/A/133/2011, të datës 7 dhjetor 2011 lidhur me pronën e kërkuar. Nga formulari i ankesës së tij shihet se ai e ushtron ankesën kundër vendimit të KKPK-ës si tërësi.

11. Ankesës së tij ankuesi ia ka bashkëngjitur edhe një deklaratë të tij (të pa datë dhe numër) dhe të nënshkruar nga 5 (pesë) persona [A.(R.) M., S. (A.) A., B. (I.) Z, H. (I.) Z dhe N. (I.) M.] nga fshati Mojstir, Komuna e Istogut, që të gjithë në cilësinë e dëshmitarëve.

12. Në deklaratën e tij, ankuesi thekson se në vitin 1980, përderisa babai i tyre (V. F.) ishte gjallë familja e tij me vendbanim të përhershëm ishte vendosur në fshatin Mojstir, Komuna e Istogut (në vendin ku gjendet edhe prona e kërkuar). Më pastaj, ankuesi thekson se diku në fillim të viteve të 80-ta familja e tij e kishte blerë pronën e kërkuar (por edhe ngastrën tjetër nr. 394) nga shitësit: G., M., M., I., R., J. dhe R. A. (në tekstin e mëtejme: shitësit). Para se familja e tij të blente pronën e kërkuar (dhe pronën tjetër) nga shitësit, pala ankuese thekson se në vitin 1954-1956 atë (pronën e kërkuar) e kishte blerë M. A. (babai i shitësve) nga kushërinjtë e tyre M. A. (bartësi i së drejtës pronësore) dhe Ž. A.

13. Paraqitësi i ankesës, gjithashtu thekson se në fakt prona e kërkuar dhe e blerë nga familja e tij prej shitësve të sipër theksuar kishte qenë në emër të M. A. (bartësit të së drejtës pronësore) dhe Ž. A. (me gjasë vëllait të tij). Çmimi i shitblerjes (shuma në vlerë prej 240.000,000 dinar) së pronës së kërkuar sipas palës ankuese është paguar në tërësi në atë kohë (dmth në fillim të viteve të 80-ta).

14. Për më tepër, pala ankuese deklaroi se për shitblerjen e pronës së kërkuar ata kishin pasur kontrate private me shkrim, por e njëjta është zhdukur gjatë luftës së vitit 1999. Sipas tij ata kishin përmbushur të gjitha kushtet e parapara kontraktuese. Ai tutje shton edhe se për shkak të situatës politike në Kosovë ata nuk kishin pasur mundësi të lidhnin kontratë formale dhe të vërtetuar pranë Gjykatës kompetente. Që nga ajo kohë sipas tij prona e kërkuar i ishte dorëzuar atyre në posedim, shfrytëzim dhe pronësi faktike gjë që edhe tani e bëjnë. Në fund të deklaratës së palës ankuese në cilësinë e dëshmitarëve janë shtuar edhe nënshkrimet e

(5) personave të sipër cekur (ankesës së ushtruar i janë bashkëngjitur edhe letërnjoftimet e këtyre personave nënshkrues).

15. Ashtu siç edhe u theksua më lartë përveç të dhënës se ankesa ushtrohej ndaj tërë vendimit të KKPK-ës, në ankesën e tij të paraqitur pala ankuese nuk thekson asgjë më shumë. Për më tepër, në ankesën e tij ankuesi as nuk kërkon dhe propozon gjë për Gjykatën.

16. Ankesa i është dorëzuar vëllait të paraqitësit të kërkesës (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në ankesë) R. A. me 21 tetor 2013 dhe jo atij për shkak të gjendjes së tij shëndetësore. Me datë 4 nëntor 2013, vëllai i palës përgjegjëse në ankesë, R. A., ka paraqitur ekstraktin nr.241 datë 26 tetor 1981, nga libri amëz i të lindurve për veten e tij dhe letërnjoftimin e tij nr. 461803 lëshuar me datë 10 mars 2008 nga Republika e Serbisë. Pala përgjegjëse në ankesë dhe vëllai i tij nuk kanë paraqitur përgjigje në ankesë.

### **Të gjeturat e gjykatës:**

17. Ankesa është e palejueshme.

18. Në pajtim me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut për zgjidhjen e kërkesave pronësore lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejme Ligji nr. 03/L-079), *pala* mund të paraqes ankesë brenda (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës mbi vendimin e Komisionit për kërkesën. Po ashtu, nenet 176.1 dhe 177.1 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore parashohin se e drejta për të paraqitur ankesë i përket *palëve* të procedurës së shkallës së parë.

19. Në rastin konkret, pala ankuese nuk ka qenë palë në procedurën e shkallës së parë para KKPK-së.

20. Prandaj, e drejta e palës ankuese për të paraqitur ankesë kundër vendimit të kontestuar varet nga fakti nëse është njoftuar me rregull për kërkesën. Mënyra për njoftimin e një kërkesë në këtë procedurë parashihet me nenin 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Sipas kësaj dispozite, Sekretaria Ekzekutive e njofton dhe i dërgon nga një kopje të kërkesës çdo personi, përpos paditësit, i cili aktualisht ushtron apo pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës dhe bën përpjekje të arsyeshme për të njoftuar çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në këtë pronë.

21. Më 2 prill 2008, AKP-ja kishte vendosur shenjën e njoftimit në pronë me informatat ligjërish të obligueshme rreth kërkesës në gjuhët shqipe, serbe dhe angleze. Kjo dokumentohet me raportin e ekipit njoftues të AKP-së, fotografive dhe skicës së hartuar të lokacionit të pronës së kërkuar. Fotografitë dëshmojnë se shenja ishte vendosur në një hapësirë të sheshtë - në një vend të hapur ku shenja mund të shihej qartë.

22. Pala ankuese pretendon se familja e tij kishte në posedim pronën e kërkuar gjatë tërë kohës. Si rrjedhojë, nuk ka ndonjë indikacion se ata kanë mundur të mos e vërejnë shenjën dhe të mos kenë pasur dijeni për kërkesën.

23. Duke ardhur në konkludim nga të gjitha rrethanat e lartcekura, Gjykata Supreme konsideron se pala ankuese ka pasur mundësi të jenë në dijeni për procedurën dhe ta paraqes mbrojtjen e tij në shkallën e parë. Pasi që ai nuk është përgjigjur në kërkesë brenda afatit ligjor dhe rrjedhimisht nuk është bërë palë në procedurën para KKPK-së, ai nuk lejohet të paraqes ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimit të KKPK-së. Prandaj, ankesa hedhet poshtë si e papranueshme sipas nenit 13.3 (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (shih po ashtu nenet 196 dhe 195.1 (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore).

24. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme e Kosovës vendos sikurse në dispozitiv.

**Udhëzim juridik:**

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini Kryetar i Kolegjit**

**Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it**

**Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**